



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:210135

Datë: 30.12.2021

Numri i dokumentit: 02568395

PPP.nr.38/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit N. O. Fsh P. Rr. I. O. p/n Istog, kundër debitorit A. B. nga Fsh.G. Komuna e Istogut, për shkak të borxhit në shumë prej 1,190.00€, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt: 03.09.2021, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.285/2021 të dt.26.08.2021, jashtë seance me dt.30.12.2021 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET prapësimi i debitorit A. B. nga Fsh.G. Komuna e Istogut, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr.285/2021 të dt.26.08.2021, si dhe **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.285/2021 të dt.26.08.2021, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

A r s y e t i m

Kreditori, N. O. Fsh P. Rr.I. O. p/n Istog ka ushtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarimor- Aktgjykimit, duke kërkuar që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet debitori pagesën e borxhit në shumë prej 1,190.00 €, dhe shpenzimet e procedurës përmbarimor, të gjitha në afat 7 ditor nga dita e pranimit të propozimit, në të kundërtën ti bllokoj të gjitha llogarit bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjetet monetare në llogari të behet sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme dhe mjetet e mbledhura të barten

në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim te datës 26.08.2021.

Përmbaruesi privat, me urdhrin P.nr.285/2021 të dt.26.08.2021, e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit te kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, A. B. nga Fsh. G. Komuna e Istogut, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrin përmbarimor, me kërkesë që te anulohet urdhri përmbarimor me arsyetimin se shuma e kërkuar nga kreditori për shkak te gjendjes se dobët ekonomike nuk kam mundësi që ta paguaj pasi që jetoj vetëm me një pension për te verbër ku dhe me të e mbaj familjen, ashtu që me lejimin e këtij urdhri do te rrezikohet ekzistenca e familjes dhe e e imja

Pas ngritjes se prapësimit nga debitori, kreditori është njoftuar me te njëjtin si dhe me mundësin e parashtrimit te përgjigjes ne prapësim, mirëpo ne shkresa te lëndës nuk ka dëshmi që ka parashtruar përgjigje.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësim të debitorit tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar me urdhër përmbarimor.

Gjykata, pas shqyrtimit te prapësimit si dhe pas shqyrtimit te provave tjera ne shkresat e lëndës, zyrtarisht vlerësoj lejimin e përmbarimit, konkretisht vlerësoj dokumentin përmbarimor ne bazë te se cilit është lejuar përmbarimi se a i plotëson kushtet ligjore si dhe i njëjti dokument a është i përshtatshëm për përmbarim ashtu siç e parashohin dispozitat ligjore te LPP-së, konkretisht neni 21, 22 par.1.1 e ne lidhje me nenin 27 par.1 te LPP-së i cili nen parasheh se “Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përbushjes së detyrimit”, e ne rastin konkret vendimi C.nr.229/2015 i dt. 31.07.2017, edhe për kundër faktit që i njëjti është i plotfuqishëm, i njëjti është i pa përshtatshëm për përmbarim sepse askund ne diapozitiv të të njëjtit nuk është përcaktuar shuma te cilën e kërkon kreditori ne këtë çështje përmbarimore.

Gjykata ne bazë te rrethanave te krijuara, pasi që vendimin me të cilin është lejuar përmbarimi nuk e konsideroj të përshtatshëm për përmbarim, nuk u lëshua ne vlerësimin e pretendimeve tjera te palëve në këtë procedurë, ashtu që vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi duke e aprovuar prapësimin e debitorit dhe duke shfuqizuar urdhrin përmbarimor si dhe i abrogoj te gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 21, 22, 27 par.1, 69, 71 e 73 par. 3, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, gjykata vendosi si në diSpozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:210135
Datë: 30.12.2021
Numri i dokumentit: 02568395

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.38/2021 dt.30.12.2021

GJ Y Q T A R I
Blerim Istrefi

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.